



Republika e Kosovës -Republic of Kosovo- Republika Kosova

Komuna Obiliq- Obiliq Municipality-Opština Obilič



KOMUNA E OBILIQIT



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIČ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRQJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



ZYRA E PROKURIMIT

Dalës-izlaza

Nr. XIII-467
Br.

Data

Datum

28.12.2020

OBILIQ-OBILIČ

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË SHËRBIM

Nr.:077/2020

Nr	Titulli i Kontratës
	Mirëmbajtja higjienike dhe pastrimi i objekteve të Shtëpisë së Kulturës Xhavit Haziri dhe Palestrës Sportive Adem Jashari

Dhjetor/2020
Obiliq

PJESA B: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË 1, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

KOMUNA E OBILIQT-zyra e prokurimit Rr. „Adem Jashari”15000- Obiliq

, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;
dhe

Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë, Rexhep Krasniqi PN, 10000, PrishtinëNRB. 810804999

Përfaqësuar nga: Islam Morina Drejtor

}} (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

Mirëmbajtja higjienike dhe pastrimi i objekteve të Shtëpisë së Kulturës Xhavit Haziri dhe Palestrës Sportive Adem Jashari me numër identifikues: OB614-20-7393-2-2-1 & Numri i brendshëm 614 20 077 221

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Lënda e kontratës ka të bëjë me Mirëmbajtjen higjienike dhe pastrimi i objekteve të Shtëpisë së Kulturës Xhavit Haziri dhe Palestrës Sportive Adem Jashari dhe punë sipas kushteve dhe specifikave teknike të dhëna në dosjen e tenderit, nga ana e Kontraktuesit sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertes financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

[Përdorimi i kësaj kontrate publike kornizë është i detyrueshëm për të gjitha njësitë s Autoritetit Kontraktues

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.3.1 Kjo kontratë publike kornizë ka kohëzgjatje prej 36 muajsh dhe është efektive

prej datës në të cilën ajo hyn në fuqi

1.4 Kontrata hynë në fuqi me [28-12-2020 dhe përfundon në datën [01.01.2024]

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë [1 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë [Vendi i performimit të shërbimeve është: Shtëpia së Kulturës Xhavit Haziri dhe Palestra Sportive Adem Jashari në Obiliq}}

¹ Para nënshkrimit të kontratës "kjo Draft Kontratë Publike Kornizë " duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit të prokurimit

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Mërkmbajtja higjienike dhe pastrimi i objekteve							
Tab.1	PËRSHKRIMI	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Shuma Mujore	Shuma Vjetore{12 muaj}	Gjithsej Çmimi për 36 muaj
			A	B	C=A *B	D=C*12	E=C*36
1	Objekti i Shtëpisë së Kulturës "Xhavit Haziri" (Hapësirat e Mbrendëshme)	M ²	1.300,20	0,41 €	533,08 €	6.396,98 €	19.190,95 €
2	Objekti i Palestrës Sportive Adem Jashari (Hapësirat e Mbrendëshme)	M ²	3.200,00	0,41 €	1.312,00 €	15.744,00 €	47.232,00 €
Totali					1.845,08 €	22.140,98 €	66.422,95 €

Vlera totale indikative e kontratës është [66.422,95 Euro.gjashtëdhjet e gjashtëmi e katërqind e njëzet e dy euro 95/100 Sasia është sasi e përafërt e parashikuar gjatë 3 vjet apo 37 muajve sa do të jetë kohëzgjatja e kontratës.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Kontrata Publike Kornizë;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet


5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët [Shqipe] [Serbe]² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Sherif Hoti
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	28-12-2020
Vula:	



Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Islam Morina
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	28-12-2020
Vula:	



² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

- 1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.
- 1.2 **"Shërbimet"** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 **"Ofrues i shërbimeve"** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 **"Personeli"** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 **"Nënkontraktuesi"** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 **"Palë"** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 **"Autoriteti Kontraktues"** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 **"KPK"** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 **"KVK"** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj të një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguheshin ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
 - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguresve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrin me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospective dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjанuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar

shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrat. Ekzekutimi i urdhrat administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për asnjë kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

Neni 12 Obligimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13

Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vetë Autoritetit, me një operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vetë Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bërë porosinë anulon porosinë dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së lëshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- të njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së lëshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15

Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16

Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-në për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike komizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17

Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18

Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19

Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

a) dëmet; dhe/apo

b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

a) dëme të përgjithshme; ose

b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arrijtjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a) vendim nga gjyqi; ose

b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëmet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë asetit të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë

PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë [Gjuha Shqipe
Transferimi	3.2	Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste
	3.3	Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
Nën-kontraktimi	4.2	Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.
Tatimi	5.1	Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.
	5.2	Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve
	5.3	Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së

		detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve
Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve	6.1	Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet nga 01-01-2021 pas nënshkrimit të kontratës Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë {36} Muaj nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues Operatori Ekonomik duhet të ofrojë shërbim të rregullt prej orës {7:00-15:00} për çdo ditë pune {Hane-Premte}
	6.4	Data e Përfundimit është: 10.04.2021 Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është në Objektin e Komunës dhe në Objektin e QPS
Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues	9.1	Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme: (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sip
Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve	10.1	Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues; a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit; b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafte të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.
Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve	11	11.1 Operatori Ekonomik do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale. 11.2 Operatori Ekonomik duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit.

	Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi. 11.3 Operatori Ekonomik duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve. 11.4 Operatori Ekonomik do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues. 11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues. 11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar. • Te gjitha shërbimet duhet te kryhen ne menyre te qete, disiplinuar, te rregullt dhe efikase ne menyre qe te mos pengohet personeli qe punon ne zyre, vizitoret ose aktivitetet qe ndodhin ne hapësirën ku behet pastrimi. Te gjitha materialet, paisjet dhe mjetet tjera duhet te vendosen ne vende te caktuara ne menyre qe te jene larg syve te personelit qe punon neper zyra ne kohen kur ato nuk perdoren. • Operatori Ekonomik është i obliguar qe te siguroje personelit
--	--

		punonjes, mbikqyrjen, paisjet, mjetet, materialin shpenzues per pastrim, kemikalet, transportin dhe gjesendet tjera qe jane te nevojshme per te kryer punet si kurse kerkohet ne dokumentin ofertues. • Gjithashtu Operatori Ekonomik është përgjegjës për sigurimin e materialit pastrues, furnizimeve tjera, agjenteve për pastrim, materialeve dhe mjeteve tjera të specializuara si dhe transportimin e tyre në mënyrë që të bëjmë ekzekutimin e punëve në mënyrë sa më profesionale. • Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha uniformat dhe mbulesat e trupit, në vendet ku dhe si nevojiten duhet të furnizojmë uniforma mbrojtëse të cilat nuk do të kufizohen vetëm në, doreza, syze mbrojtëse, maska për fytyrë, çizme mbrojtëse për shputa si dhe helmata në mënyrë që ti përgjigjen kërkesave të standardeve europiane për siguri dhe shëndet në punë. • Operatori Ekonomik duhet të ketë në dispozicion dhe të shpërndajë materialet e pastrimit ku dhe si do të nevojitet. Komuna do të sigurojë hapësirë të nevojshme në mënyrë që ofertuesi i suksesshëm të mund të kryejë punët e perdritshme në mënyrë të krenarshme. • Operatori Ekonomik duhet të sigurojë një person i cili do të kryejë punët në lidhje me menagjimin e kontratës i cili do të ketë për detyrë që të monitorojë të gjitha aktivitetet në bazë të kontratës si dhe të Planprogramit të shërbimeve të pastrimit si dhe të koordinojë punët me menagjerin e kontratës nga ana e Komunitetit të Obilitetit. • Personeli i pastrimit duhet të dislokohe në atë mënyrë që të mund të kryejë shërbime të shpejta dhe efektive të pastrimit. • Seciles/it punëtorë duhet të ipen në formë të shkruar në detaje detyrat dhe përgjegjësitë me të cilat ngarkohet ai dhe ky dokument do të jetë i kuptueshëm në mënyrë që ato të mesojnë për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. • Operatori Ekonomik duhet të ofrojë shërbim të rregullt prej orës {7:00-15:00}për çdo ditë pune{Hane-Premte}, për punëtorët të cilët duhet të jenë në objekte si më poshtë, ky orar mundet me ndryshuar me vendim të Komunitetit, në atë rast do të aplikohet orari i ri • Orari i paraqitur nuk do të vlejë asnjëherë kur të ketë nevojë për të kryer ndonjë punë e cila nuk ka përfunduar gjatë orarit të rregullt të punës, apo në kërkesë nga përgjegjësit e AK për të vazhduar punën gjatë ditëve të punës apo për të punuar edhe gjatë fundjavës,
--	--	---

		pa kompensim shtesë financiar në emër të punës jashtë orarit, kjo vlen për të gjithë punëtorët e kompanisë pa përjashtime sipas nevojës • Operatori Ekonomik është i obliguar që paga e punëtorëve do kryhet në kohen e duhur dhe vlerën e DUHUR • Në aspektin e Kontrollimit të Kualitetit Ofertuesi duhet të deshmojë se si do të organizojë programin e Mirembajtjes Preventive, program sipas të cilit punëtorët e mirembajtjes në baze ditore bëjnë inspektime të nyjeve sanitare, rrjetit elektrik dhe puneve të zdrukthtarisë. Operatori Ekonomik duhet të kuptojë se të gjitha shërbimet duhet të jenë profesionale dhe ti përmbushin të gjitha kërkesat të cilat janë parashtruar në dokumentin ofertues në mënyrë detale.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.1	12.1.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave. 12.1.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën. ▪ 12.1.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “Menaxherin e Projektit”, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues ▪ Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e shërbimeve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord ▪ Menaxheri i Kontrates duhet të hartoj planin për menaxhimin e kontratës, dhe në bashkëpunim me OE do të jenë në dispozicion çdo here që kërkohej dhe do të ketë autoritetin për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhe çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontrates.
	12.2	12.2.1 të siguroj hapësirën për kujdestari, për vendqëndrimet e ekipeve të punëtorëve të kontraktorit në kuadër të ndërtesave të cilat do të mirëmbahen nga kontraktori, 12.2.2 -sigurimin e dokumentacionit teknik (i cili nuk është i kompletuar dhe në masë të madhe mungon) sipas kërkesave nga kontraktori, 12.2.3 të siguroj dhe organizoj krijimin e kushteve normale të punës

		duke bashkëpunuar dhe udhëzuar sipas nevojë punëtorët e kontraktorve, 12.2.4 siguroj kartelet identifikuese për qasje në ndërtesa sipas këkesës nga menaxhmenti i kontraktorit e sipas procedurave të AK. 12.2.5 siguroj kartelet identifikuese leje për qasje në ndërtesa për mjetet transportuese të kontraktorit sipas këkesës nga menaxhmenti i kontraktorit dhe sipas procedurave të AK
Dëmet e Likuiduara	13.	13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara si: a) moskryerja e shërbimeve në tërësi apo pjesërisht sipas cilësisë së nevojshme e të kërkuar, b) zgjatja e afatit të kryerjes së punëve, c) moskompletimin me kryrës të nevojshëm si dhe të kërkuar nga punëdhënësi, d) Lëvizjet e punëtorëve të kontraktorit nga njera {pjesë apo katë} në tjetrën {pjesë apo katë} për kryerjen e punëve të kërkuara në njerën {pjesë apo katë} duke lanë anash pjesën tjetër {pjesë apo katë} nga i ka transferuar punëtorët. e) mosrespektimi i mirësjelljes, orarit, qëndrimit ndaj punëve, qëndrimit ndaj shërbyesve civil, keqpërdorimi i vendit të punës në krahasim me vendin ku punon e të ngjashme, AK mundë të ketë edhe kërkesa për largimin e punëtorit / es të kontraktorit nga vazhdimi i punës në objektin e komunës për kryerjen e shërbimeve nga kontraktori. , Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Sherbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit te Sherbimeve 13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise. 13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së

		paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të: - konfiskojë garancinë e performancës; - të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe - të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.
Siguria e ekzekutimit	14.	14.1 Furnizuesi, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, do të dorëzojë tek Zyra e Prokurimit një sigurim për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve. Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës: 6.642.30€ me afat të vlefshmërisë prej 37 muaj
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	15.1.1 Ofruesi i Shërbimeve do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do të sigurojë Autoritetin Kontraktues dhe Menaxherin e Projektit kundër, çdo kërkesë për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkatohen nga ekzekutimi i kontratës nga ofruesi i shërbimit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tij. 15.1.2 Ofruesi i Shërbimeve do të jetë tërësisht përgjegjës për dëmet eventuale në pronën,. Çdo dëmtim i shkaktuar do të korrigjohet nga ofruesi i shërbimeve në shpenzime të veta. Ofruesi i Shërbimeve duhet të sigurojë që i gjithë stafi i tij, i cili kryen shërbimet, janë të siguruar plotësisht dhe kane përgjegjësinë për ndonjë dëm nga ta.
	15.2	Kontraktori është përgjegjës për aplikimin e ligjeve për mbrojtje në punë të punëtorëve të tij përveç tjerash edhe duke : - bërë sigurimin e zonave të punës për kryerjen e punëve në mënyrë të sigurt - duke u siguruar në gatishmërinë profesionale të punëtorëve, - duke u siguruar në përdorimin e drejt të veglave dhe mjeteve adekuate dhe funksionale nga punëtorët, - duke obliguar punëtorët që të mbajnë uniformat e kompanisë (uniforma duhet identifikuar kompaninë) si dhe rrobat e punës dhe mjetet mbrojtëse në punë si : rrobe pune, helmeta, këpucë adekuate varësisht nga natyra e punës dhe stina, syza mbrojtëse, dorëza pune ...etj. - nga bartja e uniformës lirohet vetëm menaxheri kryesor – drejtori i kompanisë dhe askush tjetër nga punëtorët e kompanisë,

		varësisht nga natyra e punës të angazhoj punëtorë me kualifikime adekuate, njohuri dhe përvojë të duhur për kryerjen e punëve të nevojshme
Parimet të përgjithshme të pagesave	16.	16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare. 16.2 Shumat duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore. 16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur. 16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet). 16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve:

	Kontrolli i kualitetit të shërbimeve behet nga personat përgjegjës të Autoritetit Kontraktues që shfrytëzojnë kontratën. Ofruesi i shërbimeve do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Ofruesi i shërbimeve do të garantojë që asnjë nga materialet e përdorura të mos kenë efekte anësore në shendetin e personelit që shkaktojnë erë të keqe dhe të damshëme . Ofruesi i Shërbimeve do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat: a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Ofruesi i Shërbimeve; ose b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Ofruesit i Shërbimeve gjatë periudhës së garancisë; ose c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij. Ofruesi i Shërbimeve me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. periudha e garancisë do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi. Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të: a) të korrigjojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Ofruesit të Shërbimeve, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhet ose garancitë që mbahen prej Ofruesit të Shërbimeve ose nga të dy;ose b) të ndërpresë kontratën. Në raste urgjente, kur ofruesi i shërbimeve nuk mund të gjendet menjëherë, ose, edhe nëse është kontaktuar por nuk është në gjendje të marrë masat e nevojshme, Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i Projektit mund të kryejnë punën me shpenzime të Ofruesit të Shërbimeve. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i Projektit do të
--	---

		informoj sa më shpejt të jetë e mundur Ofruesin e Shërbimeve për veprimin e marrë
Përmirësimi i Defekteve	18.1	Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për atë kohë sa Defektet të korrigjohet.
	18.2	Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues
	18.3	Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.
Konsekuencat e Shkeljes se kontratës	19.1	Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Të gjitha mosmarrëveshjet do të tentohet që të zgjidhen në mënyrë miqësore nga Projekt menaxheri i kontratës, personat përgjegjës të Autoritetit Kontraktues, Zyrtarin përgjegjës të prokurimit si dhe personave përgjegjës të autorizuar nga Kryesi i shërbimeve.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, në pajtim me ligjin e Kosovës

Aneksi 1.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Të dhënat e nevojshme për kryerjen e shërbimëve, punëve rreth pastrimit dhe mirëmbajtjes

a. SHERBIMET E PASTRIMIT:

1. Pastrimi i rregullt ne baze te Planprogramit te Pastrimit.
2. Pastrimi periodik ne baze te Planprogramit te Pastrimit.
3. Pastrimi fillestar dhe/ose pastrimi perfundimtar i objekteve te reja apo te renovuara si dhe kur kerkohet.
4. Pastrimi i thelle (gjeneral) ne baze te Planprogramit te Pastrimit.
5. Deponimi i mbeturinave/prodhimeve te letres neper deponite e caktuara per reciklim.

A..PLANPROGRAMI I SHERBIMEVE TE PASTRIMIT.

Ofertuesi i suksesshem duhet qe te beje pastrimin e nderteses sikurse kerkohet ne dokumentin ofertues ne baze te standardeve te pastrimit dhe ne pajtueshmeri me kerkesat e cekura ne dokumentacionin ofertues.

b. **KODET E FREKUENTIMIT:**

- Ditore apo si kerkohet (sipas nevojës).....D-SN
- Dy here ne dite..... 2D
- Javor..... J
- Javor si kerkohet.....J-SN
- Dy here ne jave.....2J
- Cdo dy jave.....J2
- Mujor.....M
- Cdo 2 muaj.....M2
- Cdo 3 muaj..... M3
- Cdo 6 muaj.....M6
- Si kerkohet-sipas nevojës.....SN

1.HAPESIRAT SPECIFIKE.

Toaletet – e meshkujve dhe femrave.

Pastrimi i dyshemese

D dhe SN

- Larja e dyshemese me uje te vaket dhe shampun/D
- Larja, gerryerja dhe dezinfektimi i te gjitha tiganëve dhe kapakeve neper toalete, urinare, tush kabina dhe lavabo/ D
- Larja dhe terja e pasqyreve/D
- Zbrazja, pastrimi dhe dezinfektimi i shportes per mbeturina /D dhe SN
- Larja e mureve, pjeseve te drurit, ndarjeve dhe dyerve/D
- Zevendesimi i letres se toaletit, letres peshkir, sapunit dhe deodoranteve per urinare / D dhe SN
- Pastrimi i pluhurit nga mobiljet, dritaret dhe radiatoret /D
- Pastrimi i pluhurit nga tavani / J
- Pastrimi dhe terja e pjeseve te brendshme dhe te jashtme te dritareve -M2

2.Hapesirat e perbashketa (hyrjet, hollet, shkallet dhe korridoret).

- Pastrimi dhe larja e dyshemesë D
- Pastrimi i dyshemeve të drunjta D
- Larja e dyshemeve D-SN
- Pastrim i mureve, dyerve, pjeseve të drunjta dhe tepiheve D-SN
- Zbrazja e shportave per mbeturina D
- Deponimi i paketave, ambalazhes dhe mbeturinave tjera nga zyret SN
- Pastrimi i shpuzoreve te cilat gjenden neper hapesirat ku lejohet pirja e duhanit dhe para hyrjeve te nderteses D-SN
- Vakuumimi i hapesirave te mbuluara me tepih D
- Pastrimi i dyerve, dorezave te dyerve dhe pjeseve tjera te dyerëve te ndryshme D
- Pastrimi i pluhurit nga kornizat, tabelave per udhezim dhe mobiljeve J
- Pastrimi i pluhurit nga ramat e dritareve, dyerve, mureve, tavanit, ngroheseve/radiatoreve dhe kapakeve te dritave J
- Larja e mureve, dyerve dhe lustrimi i tyre M3
- Larja dhe pastrimi i pjeseve te brendshme dhe te jashtme te dritareve M
- Shamponimi i tepiheve M

3. Zyret, Auditoriumet, Sallat

- Deponimi i mbeturinave nga imtesuesit e letres si dhe veqimi i tyre nga mbeturinat tjera per qellim reciklimi
D-SN

- Pastrimi i makinave per imtesim te letres D-SN
- Zbrazja e mbeturinave nga shporta D
- Zbrazja e kutive per reciklim te letres D
- Deponimi i kutiave te kartonit ne piken per deponim te kartonave D-SN
- Pastrimi dhe larja e dyshemese D
- Pastrimi detal i mureve, dyerve, pjeseve te drunjta dhe tepiheve D
- Larja e dyshemese D
- Vakuumimi i siperfaqeve te mbuluara me tepih D
- Pastrimi i pluhurit nga mobiljet, ramat e dritareve, ngrohjesve/radiatorëve dhe gypave te radiatorëve

J

- Pastrimi dhe disinfektimi i telefonave J
- Larja dhe pastrimi i pjeseve te brenshme te dritareve J
- Larja dhe pastrimi i pjeseve te brenshme dhe te jashtme te dritareve M
- Shamponimi i tepiheve M
- Larja e mureve, dyerve dhe pjeseve tjera te drurit dhe lustrimi i tyre M3
- Pastrimi dhe lustrimi i mobiljeve J
- Pastrimi i mveshjeve te mobiljeve si dhe lustrimi i tyre J

4. Depote dhe dhomat e furnizimit.

- Pastrimi i hapesirave dhe deponimi i mbeturinave D
- Pastrimi i gjithë hapesires me fshese te terur J
- Pastrimi i pluhurit nga mobiljet J
- Pastrimi i mureve dhe siperfaqeve te drurit J

5. Aktivitete te pergjithshme- qe nuk jane cekur paraprakisht.

- Zbrazja e shportave te medha nga koridoret D/SN
- Ujitja e luleve 2J
- Pastrimi i pluhurit nga kapaket e dritave M
- Pastrimi i roletave veneciane horizontale dhe vertikale 2M
- Larja e kapakeve te dritave M
- Pastrimi i radiatorëve dhe gypave te ngrohjes qendrore me uje dhe detergjent M
- Hjekja e perdeve dhe pregaditja e tyre per pastrim kimik M3

B Përgjegjësitë e përgjithshme.

Ofertuesit janë të obliguar që të sigurojnë personelin punonjes, mbikqyrjen, paisjet, mjetet, materialin shpenzues për pastrim, kemikalet, transportin dhe gjesendet tjera që janë të nevojshme për të kryer punët si kurse kerkohet në dokumentin ofertues.

Gjithashtu ofertuesit duhet të jenë përgjegjës për sigurimin e materialit pastrues, furnizimeve tjera, agjenteve për pastrim, materialeve dhe mjeteve tjera të specializuara si dhe transportimin e tyre në mënyrë që të bëjnë ekzekutimin e punëve në mënyrë sa më profesionale.

Ofertuesit duhet të jenë përgjegjës për të gjitha uniformat dhe mbulesat e trupit, në vendet ku dhe si nevojiten duhet të furnizojmë uniforma mbrojtëse të cilat nuk do të kufizohen vetëm në, doreza, syze mbrojtëse, maska për fytyrë, çizme mbrojtëse për shputa si dhe helmata në mënyrë që t'i përgjigjen kërkesave të standardeve europiane për siguri dhe shëndet në punë.

Ofertuesit duhet të kenë në dispozicion dhe të shpërndajnë materialet e pastrimit ku dhe si do të nevojitet. Komuna do të sigurojë hapësirë të nevojshme në mënyrë që ofertuesi i suksesshëm të mund të kryejë punët e perdritshme në mënyrë të krenarshme.

Ofertuesi i suksesshëm duhet të sigurojë një person i cili do të kryejë punët në lidhje me menagjimin e kontratës i cili do të ketë për detyrë që të monitorojë të gjitha aktivitetet në bazë të kontratës si dhe të Planprogramit të shërbimeve të pastrimit si dhe të koordinojë punët me menagjerin e kontratës nga ana e Komunës së Obiliqit.

Personeli i pastrimit duhet të dislokohe në atë mënyrë që të mund të kryejë shërbime të shpejta dhe efikase të pastrimit.

Seciles punëtorë duhet t'i ipen në formë të shkruar në detaje detyrat dhe përgjegjësitë me të cilat ngarkohet ai dhe ky dokument do të jetë i kuptueshëm në mënyrë që ato të mesojnë për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

Ofertuesi duhet të ofrojë shërbim të rregullt 7 ditësh ose 40 orësh për javë sikurse edhe çeket në planprogramin e pastrimit. Paralajmërimi dhe marrëveshja është e nevojshme në rastet kur nevojitet pastrim jashtë orarit të rregullt të punës ose gjatë uikendëve dhe festave ose ndodhivë të ndryshme. Komuna e Obiliqit nuk do të bëjë pagesë shtesë në rastet e lartepërmendura kur pastrimit duhet të bëhet jashtë orarit të rregullt të punës.

Në aspektin e Kontrollimit të Kualitetit Ofertuesi duhet të deshmojë se si do të organizojë programin e Mirembajtjes Preventive, program sipas të cilit punëtorët e mirembajtjes në bazë ditore bëjnë inspektime të nyjeve sanitare, rrjetit elektrik dhe punëve të zëdukthtarisë.

Oferuesi duhet të kuptojë se të gjitha shërbimet duhet të jenë profesionale dhe t'i përmbushin të gjitha kërkesat të cilat janë parashtruar në dokumentin ofertues në mënyrë detale.

C.Procedurat që duhet bërë gjatë Pastrimit Gjeneral.

Të gjitha shërbimet duhet të kryhen në mënyrë të qetë, disiplinuar, të rregullt dhe efikase në mënyrë që të mos pengohet personeli që punon në zyre, vizitorët ose aktivitetet që ndodhin në hapësirën ku bëhet pastrimi. Të gjitha materialet, paisjet dhe mjetet tjera duhet të vendosen në vende të caktuara në mënyrë që të jenë larg syve të personelit që punon nëpër zyra në kohën kur ato nuk përdoren.

1. Fshirja e dyshemese me fshese të lagur dhe të terur si dhe vakuumimi i dyshemese:

- a. Te gjitha dyshemete duhet te jene te pastruara, te gjitha ndytesirat duhet te jene te larguara nga te gjitha pjeset e dyshemese, qoshet, pjeset prapa dyerve si dhe pjeset prapa objekteve te cilat mund te zhvendosen lehte. Te gjitha hyrjet duhet te pastrohen si dhe te gjitha mbeturinat do te largohen nga hyrjet.

2. Pastrimi dhe larja e dyshemese:

- a. Per kujdesje e vecante duhet ti kushtohet paralajmerimit te personave qe punojne neper objekte per mundesine e rreshqitjes per shkak te dyshemese se lagur, duke perfshire edhe paralajmerimet per mundesi te rreshqitjes gjate diteve me shi me ane te vendosjes se shenjave peralajmeruese. Shenjat peralajmeruese duhet te hiqen ne ate moment kur vleresohet se dyshemeja me nuk eshte e lagur dhe si e atille me nuk paraqet rrezik per punetoret ne objekt.
- b. Gjate pastrimit/larjes se dyshemese kujdes i vecante duhet te kete qe te mos sterpiken muret, mobiljet apo paisjet tjera qe mund te ndodhen ne afersi. Uji i ndotur gjate pastrimit vazhdimisht duhet te zevendesohet me uje te paster.
- c. Te gjitha mobiljet apo paisjet e zhvendosura gjate procesit te pastrimit duhet te kthehen ne vendin e tyre te meparshem posa te pastrohet hapesira ku ndodheshin.
- d. Karrigat, tavolinat e kafes, shportat ose gjesendet e ngjajshme nuk duhet te vendosen mbi tavolina gjate procesit te pastrimit.

3. Lustrimi i dyshemese:

- e. Te gjitha dyshemete, ku eshte e mundur duhet te lustrohen ne menyre te rregullt sikurse edhe kerkohet. Dyshemete duhet te lustrohen secila sipas karakteristikave te tyre.

4. Pastrimi i toaleteve:

- f. Te gjitha toaletet duhet te jene te liruara nga kundermimet gjate gjithe kohes.
- g. Te gjitha tiganet dhe kapaket, urinaret, dushet, lavamanet, vaskat ne WC duhet te trajtohen ne ate menyre qe te mos kundermojne.
- h. Te gjitha tiganet dhe kapaket, urinaret, dushet, lavamanet, vaskat ne WC duhet te pastrohen ne menyre qe ne to te mos kete pluhur, njolla, myk dhe shenja tjera.
- i. Muret dhe dyshemete ne vazhdim te tyre duhet te pastrohen dhe te mos kene njolla ose shenja tjera.
- j. Neper toalete ne menyre konstante duhet te kete uje te paster neper fuqite te cilat jane te dedikuara per kete qellim ne menyre qe toaletet te kene mundesi te funksionojne ne menyre normale.
- k. Per kujdesje e vecante duhet ti kushtohet paralajmerimit te personave qe punojne neper objekte per mundesine e rreshqitjes per shkak te dyshemese se lagur. Shenjat e paralajmerimit do te hiqen posa te teret dyshemeja.

5. Pastrimi me leckë gjysem te lagur dhe te terur te zyrave dhe hapesirave tjera.

- a. I gjitha pluhuri duhet te largohet nga vendi i cili ndodhet ne menyre sa me efektive ne ate menyre qe te mos te lihen shenja pas pastrimit te siperfaqes.
- b. Gjate pastrimit te njollave duhet te kete kujdes qe te mos demtohen siperfaqet ne te cilat jane shtresuar njollat.

6. Lokacionet per hudhjen e letres dhe mbeturinave tjera:

- a. Lokacionet per hudhjen e mbeturinave si dhe kontejneret duhet te mbahen te sigurte, te paster dhe pa kundermime si dhe do te lahen dhe dezinfektohen kurdo qe shihet nevoja.
- b. Perkuajdesje e veqante duhet ti kushtohet rrezikut nga zjarri.

7. Hapesirat per pirjen e duhanit dhe hyrjet e ndertesave.

Taketuket neper hapsirat e caktuara per pirje te duhanit duhet te pastrohen dhe lustrohen me leckë gjysem te lagur. Mbeturinat duhet te futen ne thes ne menyre qe te deponohen ne kontejnere per mbeturina jashte ndertesës dhe ato nuk duhet te sillen mbreda ne objekt. Mirepo para se ato te deponohen se pari duhet te perkujdeset qe mbeturinat e takatukeve te jene plotesisht te shuara ne menyre qe te mos shkaktohet zjarr pas deponimit te tyre.

8. Programi i mirembajtjes preventive dhe zevendesimit te materialit shpenzues.

- b. Mjeshtri i kujdesshem duhet te zbatoje inspektime te perdritshme sidomos gjate mengjesit ne menyre qe te kryeje punet e nevojshme te mirembajtjes per ckado qe paraqitet nevoja. Perveq inspektimeve te perdritshme me qellim te mirembajtjes preventive edhe pastrueset duhet te raportojne ne lidhje me defektet e mundshme tek mbikqyersja e tyre e cila me pastaj do te lajmeroje koordinatorin e objektit ne menyre qe sa me shpejt ti qaset problemit.
- c. Menaxheri i kontrates do te perkujdeset qe stoqet te mbahet ne ate nivel qe te mund ti ofroje pastrueseve material pastrues te nevojshem kurdo qe atyre u nevojitet.
- d. Dy rollne te letres se toaletit, letres peshkir dhe sapunit te dores duhet te jene te vendosura ne menyre konstante neper toalete.

D.Lista e paisjeve te renda te cilat do te perdoren per pastrimin e ndërtesës së Komunës së Obiliqit si dhe per transportimin e mjeteve dhe materialeve

PAISJET E RENDA PER PASTRIM-TE OBLIGUESHME PËR FITUESIN E TENDERIT

1. Makine per pastrimin e tepiheve
2. Makina per pastrim dhe lustrim te te gjitha llojeve te dyshemese
3. Makine per pastrimin dhe terjen e xhamave
4. Makine per pastrimin e pllakave te keramikës me ane te avullit
5. Lift per montim ne fasade te objektit i cili sherben per pastrimin e pjeseve te jashtme te objektit te cilat nuk mund te mberrihen nga mbrendia e objektit. (ose Kamoin vinq deri në 14 me)

e.Lista e paisjeve, materialeve dhe mjeteve qe do te perdoren per kryerjen e puneve te perdritshme-

E 1.Paisjet

1. THITHESE VACUUM INDUSTRIALE
2. MAKINE PER LARJEN E TEPIHEVE
3. KARROCE E MADHE PER PASTRIM TE ZYREVE
4. KARROCE ME XHOGER PER PASTRIM

5. SHKALLE TE MADHESIVE TE NDRYSHME PER PASTRIM

E 2.ARTIKUJT-MATERIALET QE DUHET TE PERDOREN PER PASTRIMIN E NDERTESES

Materialin hargjues për realizimin e mirëmbajtjes higjienike duhet ta siguroj vete kompania.

- I tërë materiali duhet të jetë i kualitetit të lartë dhe klasit të parë.
- Kontraktori,(Operatori Ekonomik)para se të filloj aplikimin e materialit, duhet sjellë mostrat për aprovim me shkrim nga menaxheri i kontratës.
- Pa aprovimin e materialit nga menaxheri i kontratës, nuk lejohet përdorimi i të njëjtit për mirëmbajtje higjienike.
- Minimumi i materialeve të nevojshme për pastrim të cilat kontraktori duhet siguruar pa ndërpre dhe në sasi të nevojshme dhe mjaftueshme pavarësisht nga shpenzimi – hargjimi i tyre janë:
Letër tualeti, dy shtresorë e bardhë e kualitetit të lartë

-Letër për duar e trashë, e bardhë, e gjerë (dyfishi i tualet letrës) e kualitetit të lartë, varësisht nga mekanizmat e instaluar për mbajtjen e letrës,

-Sapun të lëngshëm

-Dezodorant për urina le, tableta dezinfektuese, plastika – goma të shpuara,

-Sapun dezodorant (përfshirë edhe shportën) për guacka

-Dezinfektues të tualeteve

-Dorëza plastike për pastruesit

-Detergjent për pastrimin e dritareve

-Detergjent për pastrimin e dyshemesë

-Detergjent për pastrimin e tepihëve

-Qeska për të gjitha llojet e kontejnerëve - shportave të mbeturinave

-Qeska për shportat e letrave

-Dezodorans për kabinete, zyrë, salla ,

-Detergjent për pastrimin e Pllakave

-Arom WC sapun DEVIL 3X155 ML)

-Arom për zyre AIR (ME MEKANIZUM AFTO)

-Kovë për pastrimin e dyshemesë

-Makina për pastrim dhe lustrim të pllakave të mermerit - granitit

-Fshesë elektrike pa zhurmë me pjesët përbërëse

-Kripë për shkrirjen e borës , akullit,

-Kripë me rëre për shkrirjen e borës , akullit,

-Fshesa për kopsht

-Brusha të ndryshme për pastrime të tualeteve,

-Vegla të ndryshme për punët e gjelbërimit, lulet, ,rrethojat e gjalla, bari, etj

-Lecka për pastrimin e dyshemesë

-Sfungjerë (shpuzë)

-Lecka për postimin e dritareve dhe mobileve

- Polir (shkëlqyes) për mobilja
- Polir (shkëlqyes) për metal dhe mesing
- Lecka për pastrimin e dritareve
- Polir për dysHEME
- Detergjent për qeramike
- Detergjent për heqjen e njollave
- Brusha për çpluhërosje (pastrimin e pluhurit)
- Brusha për dysHEME etj
- Air freshener (sprej) 0.5 lt.
- Air fresheners për toalet 1 lt
- Shenja paralajmëruese për rrezik nga dysHEMEja e lagur

-Pajisje dhe makineri për pastrimin dhe sipas nevojës, larjen e fasadës me të gjitha pjesët përbërëse të saja si dritareve dhe elementeve tjera të pjesës së jashtme dhe brendshme të fasadës

PASTRIMI DHE MIREMBAJTJA E SIPERFAQEVE TE JASHTME

Shërbimet e kopshtarisë dhe ato të përgjithshme përfshijnë:

Mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërta tërë kohën duke pasur në gjendje të pastër dhe të rregullt, dizajnimi i kopshteve me lule, duke përpunuar dheun, pluhurosur si dhe duke ujitur sipas nevojës, prerjen e sipas nevojës së vegjetacionit,

Mirëmban pastrimin e vendkalimeve, te rasave, palltove dhe parkingjeve.

Pastrimin e përditshëm të të gjitha sipërfaqeve të jashtme nga të gjitha mbeturinat dhe larjen e sipërfaqeve me beton dhe asfalt gjatë sezonës së verës ,së paku një herë në javë me ujë me shtypje prej së paku 120 bar.kurse

Njiherit mban rregulluesin dhe gjendjen pa borë dhe akull, sipas nevojës dhe sipas kërkesës nga punëdhënësi kripas dhe hedhë rëre – krip (rerën dhe kripën e nevojshme e siguron Operatori Ekonomik.)

Pastron nga gjethet dhe mbeturinat sistemet e drenazimit, kanalizimit, ulluqeve dhe gypat tjerë

Mbaturinat e grumbulluara nga ndërtesa hedhen tek kontejneri ose te vendi tjetër deponi i përcaktuar për atë qëllim.

Mjetet e nevojshme për këto operacione:

- -Fshesat,gërshërët,aparartet për kositje dhe
- një autocisternë me vëllim së paku 6 m3 ujë dhe shtypje 120 bar. kurse për sezonën e dimrit
- Mjetet e nevojshme për pastrimin e borës

NUMRI I PUNËTORËVE DUHET TË JETË pes {5}

Nga OE-Kërkohet që pastrimi të organizohet asisoj që hapësirat e përbashkëta (korridoret, shkallët, tualetet, hapësirat e gjelbëruara, parkingjet, shtigjet e këmbësorëve, rrugët, palltot etj) të pastrohen para orës 8.00 të mëngjesit ndërsa pas orës 8.00 të bëhet pastrimi i zyrave, sallave, etj

Vrejtje:

- Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt, {min. 5 punëtorë}.
- Operatori Ekonomik duhet të deklarohet se do tu paguan punëtorëve pagën minimale në nivelin bruto prej 250,00€;
- Operatori Ekonomik duhet të deklarohet se pagat e punëtorëve do të paguaj për muajin paraprak, ma së largu deri me datë 05 të muajit në vijim , pa marr parasysh pagesën e bërë nga Autoriteti Kontraktues
- Operatori Ekonomik duhet të deklarohet se të drejtat dhe detyrat e punëtorëve do të realizohen konform rregullave dhe ligjeve të aplikuara në Kosovë,
- Operatori Ekonomik duhet të deklarohet se materialet e perdorura jane bio dhe të atestuara

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: OB614-20-7393-2-2-1

Titulli i kontratës: **Mirëmbajtja higjienike dhe pastrimi i objekteve të Shtëpisë së Kulturës Xhavit Haziri dhe Palestrës Sportive Adem Jashari**

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Mirëmbajtja higjienike dhe pastrimi i objekteve të Shtëpisë së Kulturës Xhavit Haziri dhe Palestrës Sportive Adem Jashari

3. Çmimi total i tenderit është: **66 422,95 EUR Dhe në fjalë** [shëno çmimin e tenderit në fjalë **Euro**]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 60 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse e bën këtë.

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Mirëmbajtja higjienike dhe pastrimi i objekteve të shtëpis së kulturës “Xhavit Haziri” dhe palestres sportive “Adem Jashari”

Mirëmbajtja higjienike dhe pastrimi i objekteve							
Tab.1	PËRSHKRIMI	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Shuma Mujore	Shuma Vjetore{12 muaj}	Gjithsej Çmimi për 36 muaj
			A	B	C=A *B	D=C*12	E=C*36
1	Objekti i Shtëpis së Kulturës “ Xhavit Haziri” (Hapësirat e Mbrendëshme)	M²	1.300,20	0,41 €	533,08 €	6.396,98 €	19.190,95 €
2	Objekti i Palestrës Sportive Adem Jashari (Hapësirat e Mbrendëshme)	M²	3.200,00	0,41 €	1.312,00 €	15.744,00 €	47.232,00 €
Totali					1.845,08 €	22.140,98 €	66.422,95 €



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company I.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 90185

Për KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të EFA DIENSTLEISTUNG GMBH -DEGA KOSOVë

(emri dhe adresa e "Operatorit Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Mirmbajtja higjienike dhe pastrimi i objekteve të Shtëpise së Kultures Xhavit Haziri dhe Palestres Sportive Adem Jashari**

Nr. prokurimit: OB614-20-7393-2-2-1, Nr. brendshëm: 614 20 077 221

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **6,642.30€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesen tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:


- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktore dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **6,642.30€** siç është lartëcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 1125 ditë kalendarike prej 28.12.2020 deri më 27.01.2024

Data lëshimit: 25.12.2020

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Nr i Sense **0058373**

PJESA V E KONTRATËS:

IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	Efa dienstleistung GmbH – Dega Kosovë
Adresa	Prishtinë
Qyteti	Prishtinë
Kodi Postar	10000
Kontakti	044 373 321
Telefoni	
Fax	
E-mail	efagroupshpk@gmail.com
Numri i TVSH	810804999

BANKA	
Emri	Teb Bank
Adresa	Prishtinë
Qyteti	Prishtinë
Kodi Postar	10000
Shteti	Kosovë
Llogaria Bankare	2011000168959393
IBAN (opcionale)	
BIC (Opcionale)	

SHËNIME:

VULA E BANKËS + NËNSHKRIMI I PËRFAQËSUESIT TË BANKËS (Të dyja të obliquehme)

TEB Sh.A.

28 DEC 2020

Cafa Branch



DATA + NËNSHKRIMI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË: (e obliquehme)

28.12.2020





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

ARBK

CERTIFIKAT E REGISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION

810804999

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

///

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit:
Poslovni tip:
Business type:

Dega e Shoqërisë së Huaj
Ogranke stranog društva
Branch of a Foreign Business

Adresa:
Adresa:
Address:


Rr. Rexhep Mala, Nr. 25 Alktash
Prishtinë

Data e regjistrimit:
Datum registracije:
Date of registration:

23/09/2010

11/02/2020

Data / Date / Datum



V. Jelenc

Nënshkrimi / Signature / Potpis

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: **10068206**



Nga: Kompania e Pastrimit "efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë "

Për: KUVENDI KOMUNAL - OBILIQ

Lënda: Deklarat.

Datë: 14.12.2020

Prishtinë

Kompania jonë deklaron se pajtohet dhe zotohet së do të përmbush të gjitha kërkesat lidhur me Aktivitetin e prokurimit me nr: OB614-20-7393-2-2-1 dhe me titull: Mirëmbajtja higjienike dhe pastrimi i objekteve të Shtëpisë së Kulturës Xhavit Haziri dhe Palestrës Sportive Adem Jashari.





Nga: Kompania e Pastrimit "efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë "

Për: KUVENDI KOMUNAL - OBILIQ

Lënda: Deklarat.

Datë: 14.12.2020

Prishtinë

Kompania jonë deklaron se pajtohet dhe zotohet së do të përmbush të gjitha kërkesat lidhur me Aktivitetin e prokurimit me nr: OB614-20-7393-2-2-1 dhe me titull: Mirëmbajtja higjienike dhe pastrimi i objekteve të Shtëpisë së Kulturës Xhavit Haziri dhe Palestrës Sportive Adem Jashari.

Kompania jonë deklaron se do të ofroj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt, {min. 5 punëtorë} dhe se kemi kapacitete për rritje të numrit të punëtorve sipas kërkesave tuaja.

Kompania jonë deklaron se do të paguan punëtorëve pagën minimale në nivelin bruto prej 250,00€.





Nga: Kompania e Pastrimit "efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë "

Për: KUVENDI KOMUNAL - OBILIQ

Lënda: Deklarat.

Datë: 14.12.2020

Prishtinë

Kompania jonë deklaron se pajtohet dhe zotohet së do të përmbush të gjitha kërkesat lidhur me Aktivitetin e prokurimit me nr: OB614-20-7393-2-2-1 dhe me titull: Mirëmbajtja higjienike dhe pastrimi i objekteve të Shtëpisë së Kulturës Xhavit Haziri dhe Palestrës Sportive Adem Jashari.

Kompania jonë deklaron se pagat e punëtorëve do të paguaj për muajin paraprak, ma së largu deri me datë 05 të muajit në vijim , pa marr parasysh pagesën e bërë nga Autoriteti Kontraktues.

Kompania jonë deklaron se do të respektohen drejtat dhe detyrat e punëtorëve do të realizohen konform rregullave dhe ligjeve të aplikuara në Republikën e Kosovës.

Kompania jonë deklaron se materialet e perdorura të cilat do të përdoren nga ana jonë do të jenë bio dhe të atestuara.



Nga: Kompania e Pastrimit "Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë "

Për: KUVENDI KOMUNAL - OBILIQ

Lënda: Deklarat.

Datë: 14.12.2020

Prishtinë

Kompania jonë deklaron se pajtohet dhe zotohet së do të përmbush të gjitha kërkesat lidhur me Aktivitetin e prokurimit me nr: OB614-20-7393-2-2-1 dhe me titull: Mirëmbajtja higjienike dhe pastrimi i objekteve të Shtëpisë së Kulturës Xhavit Haziri dhe Palestrës Sportive Adem Jashari.

Me këtë deklaratë deklarojm dhe zotohem se do I përmbahemi të gjitha kërkesave dhe specifikave sipas ANEKS 1.



AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI KOMUNAL - OBILIQ, RR.ADEM JASHARI, 15000, OBILIQ,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: OB614-20-7393-2-2-1

Nr i brendshëm: 614 20 077 221

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë, Rexhep

Krasniqi PN, 10000,

Prishtin, Kosovë

E-mail: efagroupshpk@gmail.com

Personi kontaktues: Islam Morina

Telefoni: 045 235 235

Faxi:

Numri fiskal: 810804999